



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.3

Prishtinë, më 27.01.2015 ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N – 302

Raport

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media me anëtarët e KPM-së lidhur me draft -strategjinë e KPM-së për digjitalizimin

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Shqipe Pantina, Zafir Berisha dhe Pal Lekaj.

Mungoi: Jelena Bontic dhe Kujtim Paçaku.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësues të OSBE-së, KDI-së dhe përfaqësues nga INDEP.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2.Takimi i Komisionit me anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media;

3.Të ndryshme.

Mbledhjen e hapi,

Sadri Ferati – duke ju drejtuar anëtarëve të KPM-së, tha se pas përfundimit të afatit për diskutim publik të Strategjisë së KPM-së për digjitalizim, komisionin e pret një punë e madhe, pasi komisioni është kompetent për shqyrtimin e Projektligjit i cili buron nga Strategjia për digjitalizim dhe lidhur me këtë strategji, ai ia dha fjalën kryetarit të KPM-së për të dhënë informacione për strategjinë.

Adnan Merovci - ai e njoftoi komisionin se afati për diskutim publik të Strategjisë së KPM-së për kalimin nga transmetimi analog në digjital ka përfunduar me 23 janar, KPM-ja të gjitha vërejtjet, propozimet e grupeve të interesit (industria mediale, shoqëria civile, etj) i ka pranuar dhe për këtë çështje KPM-ja do të organizojë dëgjim publik që është edhe detyrim ligjor, me grupet e interesit për ti shqyrtuar në detaje propozimet dhe vërejtjet e tyre, në mënyrë që pas inkuorporimit të vërejtjeve, Strategjia dërgohet në Qeveri për një miratim formal.

Ligji për digjitalizimin është i domosdoshëm kjo rrjedh nga dispozitat e ligjit për KPM-në, por ligji duhet të jetë teknik në të cilin duhet të jenë të përcaktuara procedurat e implementimit të Strategjisë.

Ligji për digjitalizim do të përcaktojë metodën dhe kushtet për transmetim digjital tokësor, procedurat për të kaluar nga transmetimi analog në transmetim digjital, planifikimin, zhvillimin dhe përdorimin e rrjeteve, të drejtat për qasje në multipleks për transmetim digjital tokësor dhe çështje të tjera me rëndësi për kalimin në transmetimin digjital.

Ligji duhet të përmbajë dispozita për procesin e ç'kyçjes së transmetimit analog dhe kalimit në transmetimin digjital, si dhe dispozita për të drejtat dhe obligimet gjatë periudhës së shkyçjes (ASO).

Qëllimi i rregullimit të ri, bëhet për të ruajtur përdorimin efikas të spektrit të radio-frekuencave, në përputhje me aktet ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare për komunikimet elektronike, shërbimet mediale audio-vizuele me mundësitë teknologjike në dispozicion.

Ai pastaj e njoftoi komisionin për çështjet, se çka nënkupton digjitalizimi në Kosovë, cilat janë përfitimet nga digjitalizimi, planin frekuencor, historinë e licencave, historinë e mediave, operatorët kabllor, etj.

Zenun Pajaziti – pyeti - cilat kanë qenë çështjet me të ndieshme që janë trajtuar dhe cilat çështje nuk janë trajtuar dhe cilat është dashur të trajtohen?

Sadri Ferati – pyeti - se si mund të fitohen kontestet gjyqësore sipas strategjisë po që se ndonjë çështje nuk është e rregulluar me ligj të veçantë dhe si është gjendja në regjion, Slloveni, Kroaci etj, dhe pse ka zgjidhur atë kohë strategjia me gjithë shpenzimet e larta që ka ngërthyer?

Shqipe Pantina – pyeti për çështjen e hartave sipas draft strategjisë, çka nënkuptojnë?

Adnan Merovci – meqë, ITU Kosovën dhe Serbinë e konsideron si një territor, hartat nënkuptojnë pikat e frekuencave të cilat Serbia i ka vë për territorin e pjesës veriore të Kosovës, për të mbuluar territorin e pjesës veriore ku KPM-ja nuk ka qasje në ato frekuenca.

Zafir Berisha – cilat praktika, të vendeve në regjion, janë marrë për hartimin e draft –strategjisë?

Adnan Merovci - janë marrë praktikatat e vendeve evropiane duke modifikuar strategjinë për t'iu shmangur sfidave që disa vende kanë pasur gjatë implementimit të digjitalizimit, në kontekst të sfidave për çështjet teknike.

Xhevahire Izmaku - ku e shihni rolin e komisionit parlamentar dhe të Qeverisë në procesin e digjitalizimit në Kosovë dhe a do të ketë KPM-ja implikime financiare në këtë proces?

Adnan Merovci – roli i komisionit është fundamental për arsye se draft-ligji kalon në komision para se të miratohet nga Kuvendi, ndërsa sa i përket rolit të Qeverisë në këtë proces, shpresojmë se Qeveria do të ketë mirëkuptim në kontekstin e mbështetjes financiare.

Alma Lama – pyeti, lidhur me hartat e mbulueshmërisë së frekuencave, sa përqind të sipërfaqes së territorit të Kosovës do të mbulohen me frekuenca, në çka mbështetet subvencionimi i programeve televizive, po që se do të jenë kanale private televizive, pse do të duhej ti mbështes shteti dhe sa do të jetë vlera për subvencione pasi që sipas strategjisë për subvencione do të jetë konkurs publik, a do të jenë këto para të taksapaguesve?

Pasi që KTV-ja dhe TV 21 kërkojnë me automatizëm të marrin frekuenca dhe se ato televizione duhet të paguajnë, çka mendoni sa do të jetë vlera si do të caktohet çmimi, a do të jetë e përballueshme vlera e çmimit për ato tv, apo pritet miratimi i ligjit.

Cili është roli i transmetuesit publik- RTK -së në këtë fazë të konkurrencës?

Adnan Merovci - rreth mbulueshmërisë, nuk kam brengë, mbulueshmëria sigurohet, frekuencat janë të ndara.

Lidhur me fondin, KMP-ja ka analizuar dhe i ka dhënë vetës një të drejtë për të inicuar qështjet e fondeve për programet, që si rregullator i përmbajtjeve programore ti inkurajojmë, por që aty nuk ka kufizime, rreth asaj se a është publike, fondet janë burime.

Qellimi ka qene që me strategji mos me i pamundesuar qeshtjen e marjes se fondeve te menaxhuara jo domosdoshmerisht te qeverise ,sepse qeveria do te shpall tendere per qeshtjet qe te tjeret konkurojne por jo nepermjet te kpm-se.

Qmimi nuk është specifikuar, kjo është qeshtje e materialit tenderues por qe kpm duhet te gjeje nje formule rreth kesaj kpm-ja nuk mundet me caktu qmim me strategji.

Pal Lekaj - pyeti si e ka menduar KPM-ja mbulueshmërinë e gjithë territorit të Kosovës me frekuencë duke pasur parasysh sfidat që Kosova do ti ketë pasi që nuk është anëtare e ITU-së?

Adnan Merovci - strategjia dhe ligji janë dy çështje të determinuara dhe të ndryshme, strategjia është udhërrëfyes, ndërsa ligji është çështje teknike me të cilin përcaktohen procedurat e implementimit deri në ç'kyqjen e sinjalit analog ndërsa me strategji përcaktohen çështjet edhe për të ardhmën.

Sa i përket ITU-së, ne përformojmë si territor, fatkeqësisht i Serbisë, por KPM-ja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe me ekspertët e Këshillit Evropian, kemi ridefinimin dhe riorganizimin e pikave të transmetimit, pasi që ato pika të transmetimit kanë qenë të identifikuar nga e kaluara.

Zenun Pajaziti – u propozojë anëtarëve të komisionit që pyetjet shitesë, po qe se kanë t'ia adresojnë KPM-së.

3. Të ndryshme:

Burim Ejupi – tha se INDEP-i si institucion i cili merret edhe me media ka përgatitur edhe një punim me temën “Liria e mediave dhe korniza ligjore si dhe krahasimin me vendet e tjera në region”, që para finalizimit të tij, ta paraqes për diskutim publik nëpërmjet një tryeze, për të cilën komisionin e ka ftuar për bashkëpunim rreth organizimit. Në mënyrë që me 3 maj 2015, sikur 4 vitet e kaluara INDEP-i del me një punim për gjendjen e mediave në Kosovë, e cila bazohet në raporte ndërkombëtare për gjendjen e mediave.

Komisioni miratoi propozimin e INDEP-it për organizimin e tryezës, që do të mbahet me 4 shkurt 2015, në ora:10:00.

Komisioni, gjithashtu, miratoi propozimin e OSCE-së për organizimin e takimit të Komisionit, me 30 janar 2015, lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës.

Mbledhja përfundoi në ora: 13:00.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
